



## BURSA PASUNIVERSITARE MASTER/KËRKIMORE NË JAPONI

Në kuadër të “Programit të Bursave” (Japanese Government Scholarship Programme: MEXT), Qeveria e Japonisë ofron 1 (një) bursë për studime pasuniversitare Master/kërkimore për kandidatë shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pasuniversitare master/kërkimore në Japoni për vitet akademike 2019-2021, në fushat e studimit në vijim:

- Shkenca shoqërore: Letërsi, histori, estetikë, drejtësi, shkenca politike, ekonomik, tregti, pedagogji, psikologji, sociologji, muzikë, artet e bukura, etj.
- Shkenca natyrore/ të aplikuara: arkitekturë inxhinieri, bujqësi, elektronikë, informatikë peshkim, mjekësi, stomatologji, etj.

### Kriteret dhe procedura e aplikimit:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në nivelin universitar bachelor/master;
2. Sfera e studimit për të cilën do të aplikohet të jetë e njëjtë ose e lidhur me degën, për të cilën kandidati ka mbaruar studimet;
3. Kandidati duhet të jenë nën moshën 35 vjeç (të ketë lindur pas datës 2 prill 1984);
4. Kandidati duhet të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Bursa e studimit mbulon të gjitha shpenzimet për ushqimin, akomodimin, programin mësimor, si dhe shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje me avion.

Ambasada Japoneze në Tiranë do të përzgjedhë paraprakisht kandidatët (faza e parë e seleksionimit) përmes shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura dhe përmes një provimi me shkrim të gjuhës japoneze/ angleze. Kjo procedurë do të shoqërohet edhe me intervista direkte me kandidatët.

Materialet informativë (Udhëzimet për procedurën e aplikimit) dhe formularët e aplikimit gjenden bashkëlidhur këtij njoftimi ose kandidatët mund t’i referohen adresës së mëposhtme të internetit:

[http://www.it.emb-japan.go.jp/italiano/albania/albania\\_index\\_EN.htm](http://www.it.emb-japan.go.jp/italiano/albania/albania_index_EN.htm)

Për sqarime të tjera lidhur me kushtet dhe procedurat e përzgjedhjes mund të kontaktoni direkt me Zyrën Kulturore e Ambasadës së Japonisë në Tiranë në adresën:

*Embassy of Japan in Albania*

*Rruga e Kavajes Nd 50, H1*

*Kodi Postar 1023, Tirana, Albania*

*Tel:(355) 4 454 7930*

*Fax:(355) 4 454 7934*

*e-mail: [kulturore@av.mofa.go.jp](mailto:kulturore@av.mofa.go.jp)*

Dokumentet si dhe formularët e aplikimit (të plotësuar) duhet t’i përcillen Ambasadës së Japonisë në Tiranë në adresën e poshtëshënuar, brenda **datës 22 qershor 2018** që është edhe data e fundit për aplikim:

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**